

Prof. Dr. Ramazan H. BOGDANI
("Mjeshtëtër i Madh")

HISTORIOFESTIVALISTIKA E FOLKLORIT SHQIPTAR

*Rrugëtimi gjashtëdhjetëvjeçar
i 14 Festivaleve Folklorike Kombëtare
(1949 - 2009)*

Kronologjia e festivaleve:

- *Festivali i Parë Folklorik Kombëtar (FK)*

Tiranë - 1949

- *Festivali i Dytë FK*

Tiranë - 1950

- *Festivali i Tretë FK*

Tiranë - 1952

- *Festivali i Katërt FK*

Tiranë - 1957

- *Festivali i Pestë FK*

Elbasan - 1966

- *Festivali i Gjashtë FK*

Gjirokastër - 1968

- *Festivali i Shtatë FK*

Gjirokastër - 1973

- *Festivali i Tetë FK*

Gjirokastër - 1978

- **Festivali i Nëntë FK**
Gjirokastër - 1983
- **Festivali i Dhjetë FK**
Gjirokastër - 1988
- **Festivali i Njëmbëdhjetë FK**
Berat - 1995
- **Festivali i Dymbëdhjetë FK**
Gjirokastër - 2000
- **Festivali i Trembëdhjetë FK**
Gjirokastër - 2004
- **Festivali i Katërbëdhjetë FK**
Gjirokastër - 2009

Rrjedhimisht, sipas dokumentacionit,
Festivali Folklorik Kombëtar - Gjirokastër 2015,
do të duhej të përcaktohej si i **pesëmbëdhjeti**.

Një veprimtari të ngjashme me *14 Festivalët Folklorike Kombëtare*,
do të përbënte

*“Manifestimi Folklorik: Takimi Kombëtar i Rapsodëve,
Këngëtarëve, Valltarëve dhe Instrumentistëve Popullorë”.*

Është zhvilluar në vitin 1967, në Lezhë, në kuadrin e
500-vjetorit të heroit Kkombëtar, Gjergj Kastriot Skënderbeu.

Historiofestivalistika e Folklorit Shqiptar

legjitimohet edhe përmes kronikave, reportazheve
dhe filmave dokumentarë.

Ato ruhen pjesërisht në:

Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit - Tiranë

Arkivi i Institutit të Kulturës Popullore - Tiranë

Faqja e internetit You Tube

Një dokumentacion i pasur gjendet edhe në

Arkivi Vetjak Ramazan H. Bogdani

Dy shtojca mbresëlënëse:

“Ndërmarrja Shtetërore e Kinematografisë Shqiptare”
dëshmon për plazmimin e disa festivaleve.

Kështu, **Festivali i Parë Kombëtar u hap në Tiranë, më 21 shtator 1949,**

në stadiumin kombëtar “Qemal Stafa”.

Në skenën e ngritur enkas, në prani të mijëra shikuesve,
morën pjesë 41 grupe folklorike, me rreth 1500 bartës nga e gjithë Shqipëria.

Sipas filmit dokumentar “Gjurmë të shpirtit shqiptar”,

në Festivalin e fundit, atë të Katërbëdhjetë,

zhvilluar në Gjirokastrë, në vitin 2009, morën pjesë 1500 bartës.

Konkurruan 18 ansamble folklorike, ndërkohë që 5 të tilla ishin të ftuar nga shqiptarët e përtejkuqijve dhe diaspora.

Sipas platformave përkatëse,

Festivalet Folklorike Kombëtare në Shqipëri

janë organizuar nga shteti përmes ish-Komitetit të Kulturës dhe Artit, ose Ministrisë së Arsimit dhe në vijim nga Ministria e Kulturës.

Drejtimi shkencor i këtyre festivaleve (pas të pestit, më 1966)

është kryer nga ish-Instituti i Folklorit, apo Instituti i Kulturës Popullore, pranë Akademisë së Shkencave (sot Instituti i Antropologjisë dhe Studimit të Artit, pranë Qendrës së Studimeve Albanologjike), si i vetmi institucion shkencor shtetëror në Shqipëri.

Festivalet janë zhvilluar me konkurrime, sipas rretheve, qarqeve ose prefekturave.

Çdo ansambël folklorik përfaqësues përbëhej

nga 60 bartës, me të drejtë konkurrimi prej 30 minutash.

Juria e çdo festivali do të shpallte fituesit:

Flamuri i Festivalit; Çmimi i Parë;

Çmimi i Dytë dhe Çmimi i Tretë.

Gjithashtu, fitonin çmime edhe grupe ose individë sipas zhanreve folklorike.

Gjatë zhvillimit të çdo festivali ose më pas,
janë organizuar *diskutime, sesione, simpoziume* ose konferenca
shkencore

për folklorin shqiptar, **tradicional dhe bashkëkohor.**

Botimet e shumta, posaçërisht nga Akademia e Shkencave,
kanë ndriçuar begatinë e folkloristikës shqiptare, **me karakter
kombëtar dhe ndërkombëtar.**

Si punonjës shkencor profesional, **kam ndjekur 12 nga 14
festivalet**, me detyrë të bashkorganizatorit, teksa do të veçoja
edhe funksionet **e të qenit anëtar jurie në disa festivale.**

Hapësira e **Historiofestivalistikës së Folklorit Shqiptar**

do të shquante edhe për zhvillimet e përtejkuqijve.

Të tilla kanë qenë festivalet e organizuara në **Kosovë, në
Maqedoni, në Malin e Zi, nga shqiptarët në Turqi si dhe nga
arbëreshët e Italisë.**

Kam patur rastin të ndjek **festivale në Kosovë** (Glllogvc -
1980 dhe Drenas - 2002),

në **Maqedoni** (Tetovë - 1995, me funksionet e kryetarit të
jurisë);

te **Arbëreshët e Italisë** (Çivita - 2000 dhe Strighar - 2003,

në të dytin si kryetar i jurisë dhe president i simpoziumit
shkencor përkatës).

Ansamble të tilla, si dhe nga diaspora, shpeshherë kanë qenë
të pranishme

si të ftuara në festivalet folklorike shqiptare.

Kam marrë pjesë si **valltar, koreograf, analist** ose **studiues**
në **18 festivale folklorike ndërkombëtare:**

Ato kanë qenë: 1. **Gjermani - 1951** 2. **Greqi - 1988** 3. **Itali - 1995**
4. **Turqi (Bursa) - 1998**, 5. **Turqi (Stamboll) -1998** 6. **Rumani -1999** 7.
Hungari - 2002 8. **Shqipëri (Përmet) - 2003** 9. **Spanjë (Baldahoz dhe**
Valle de Mene) - 2006 10. **Mali i Zi - 2007** 11. **Shqipëri (Përmet)**
- 2008 12. **Maqedoni - 2008** 13. **Shqipëri (Vlorë) - 2008** 14.
Francë - 2008 15. **Shqipëri (Vlorë) - 2009** 16. **Spanjë (Muncin) -**
2011 17. **Shqipëri (Bylis) - 2012** 18. **Silloveni - 2016.**

Në këto **veprimtari ndërkombëtare**, kam qenë i angazhuar edhe me funksione të tjera të rëndësishme.

Kështu, në Festivalin e Bursës (Turqi - 1998), isha me detyrën e anëtarit të jurisë.

Në festivalin e Stambollit (Turqi - 1998), kryetar i tryezës së rrumbullakët për zhvillimet dhe rezultatet e një festivali folklorik.

Në Bylis (Shqipëri - 2012), drejtues i simpoziumit shkencor.

Posaçërisht pas viteve '90,

Historiofestivalistika e Folklorit Shqiptar

është pasuruar ndjeshëm edhe përmes organizimeve të Festivaleve Folklorike Kombëtare,

sipas fushave përbërëse. Të tillë kanë qenë:

Festivali i Këngës Qytetare, i Këngëve Polifonike, i Rapsodëve Popullorë,

i Sazeve Popullore, i Valleve Folklorike etj.

Për fushën e **valleve** do të veçoja *Festivalin e Parë Kombëtar,*

të zhvilluar në Tiranë, në vitin 1959, teksa isha me detyrën e anëtarit të jurisë.

Kam qenë kryetar i jurisë në tre festival, të tillë si:

Librazhd - 2002; Lushnjë - 2006; Lushnjë 2014.

Të **14-të Festalet Folklorike Kombëtare objekt (1949-2009)**, domosdoshmërisht sipas programeve përkatëse, do t'i shembulloja me nga një njësi folklorike tipike, **këngë, valle ose instrumentale:**

Festivali i Parë FK - Tiranë, 1949

Valle "*Burrash e krahinës së Lumës*"

Ansambli Folklorik i KUKËSIT

Festivali i Dytë FK - Tiranë, 1950

Valle "*E bregut të Detit të Himarës*"

Ansambli Folklorik i VLORËS

Festivali i Tretë FK - Tiranë, 1952

Valle "*Fëmijësh e Peshkopisë*"

Ansambli Folklorik i DIBRËS

Festivali i Katërt FK - Tiranë, 1957
Valle *"Vajzash e Tropojës"*
Ansambli Folklorik i TROPOJËS

Festivali i Pestë FK - Elbasan, 1966
Vallja *"E Njalës"*
Ansambli Folklorik i ELBASANIT

Festivali i Gjashtë FK - Gjirokastrë, 1968
Kënga *"Pleqërishte gjirokastrite"*
me korife Xhevat Avdalli (*"Artist i merituar"*)
Ansambli Folklorik i GJIROKASTRËS

Festivali i Shtatë FK - Gjirokastrë, 1973
Kënga *"Shkon syzeza n'ar me korrë"*
Ansambli Folklorik i LEZHËS

Festivali i Tetë FK - Gjirokastrë, 1978
Kënga *"Marshalla Shqipria jonë"*
me korife Demir Zyko (*"Artist i Popullit"*)
Ansambli Folklorik i SKRAPARIT

Festivali i Nëntë FK - Gjirokastrë, 1983
Kënga *"Mejdani i Mujit me Bajlozit"*
Këndon me lahutë Llesh Prekushi
Ansambli Folklorik i LEZHËS

Festivali i Dhjetë FK - Gjirokastrë, 1988
Instrumentale matjane
me korife Ymer Neli (*"Artist i merituar"*)
Ansambli Folklorik i MATIT

Festivali i Njëmbëdhjetë FK - Berat, 1995
"Fyejt e Gramshit"
Ansambli Folklorik i GRAMSHIT

Festivali i Dymbëdhjetë FK - Gjirokastrë, 2000
Kënga "Kurvelesh' i Labërisë"
Ansambli Folkorik i TEPELENËS

Festivali i Trembëdhjetë FK - Gjirokastrë, 2004
Vallja "Malenakja"
Ansambli Folkorik i TIRANËS

Festivali i Katërbëdhjetë FK - Gjirokastrë, 2009
Vallja "Dyshe burrash e Urës Vajgurore"
Shquajnë:
Halim Plaku në kërcim
Isa Pirja në def
Ansambli Folklorik i BERATIT

Gjatë ripunimit, përshtatjes dhe redaktimit të *minivoariantit objekt* (filmimit në You Tube), rreth realizimit të tij me fizionominë e një artikulli të mirëfilltë studimor, kam hasur edhe disa kapërcylle.

Kështu, nuk kisha sesi ta përfshija *Festivalin Folklorik Kombëtar - 2015*, teksa ai është zhvilluar në po ato ditë maji 2015, njëherësh me realizimin e *variantit në You Tube*.

Rrjedhimisht, më mungonin filmimet rreth performancave dhe ilustrimeve filmike për legjimitetin në **Historiofestivalistika e Folklorit Shqiptar**.

Më shkoqur, të **14-të festivalet e trajtuara (1949 - 2009)** janë realizuar me të dy treguesit e mësipërm, siç do të veproja për *festivalin e vitit 2015*, por nuk jam ftuar për të qenë i pranishëm.

Mbase do të replikoja me faktin teksa mund të hamendësohej se filmime të atilla edhe mund të gjenden tashmë. Por, edhe parimisht, përderisa më ka munguar të përjetuarit, domethënë se "nuk kam parë gjë me sy, as prekur me dorë!", vetvetiu nuk do të isha në gjendje për t'i trajtuardukuritë përkatëse. Madje, do të krijohej edhe një handicap, ndërkohë që *filmimi i minivoariantit përkatës* është i legjitimuar tashmë në *You Tube*, maj 2015.

Sidoqoftë, më i rëndësishëm është fakti se ai festival do të shënonte për mua rendorin e pesëmbëdhjetë.

Analogji të njëtrajtshme me *festivalin e vitit 2015*, do të përbënte *festivali i vitit 1949*.

Siç është zbardhur, ky ravijëzon tashmë të parin Festival Folklorik Kombëtar në Shqipëri.

Megjithatë, edhe në këtë rast krijohet ekuivoku. Sakaq, siç jam prononcuar edhe vite më parë, një festival folklorik më i hershëm është shënuar në Tiranë në vitin 1947 (!).

Për këtë, ndonëse anashkalimthi, paskërka qenë shkruar edhe ndonjëfarë shkrimi, lajmi apo kronikë në shtypin e përditshëm, por vetëm kaq dhe jo më shumë. Pra, mungon një dokumentacion i mirëfilltë, domosdoshmërisht filmik (nga Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit, Tiranë), siç e kanë të 14-të festivalet e trajtuara më sipër.

Rrjedhimisht, ky i ashtëquajtur “Festival”, për mua nuk i përmbush parametrat për t’u renditur si i tillë në *Historiofestivalistikën e Folklorit Shqiptar*. Këtë definicion, veç të tjerash, e kam të ndërgjegjësuar tashmë nga përvoja ime si folklorist për një periudhë kohe mbi gjysmëshekullore

Më së shumti, mund të hamendësoj se, edhe pse nuk kam qenë i pranishëm, *veprimtaria folklorike e vitit 1947*, shumë – shumë ka gjasa të ketë qenë një farë **festiviteti folklorik**,

i ngjashëm me **Manifestimin Folklorik** në Lezhë, në vitin 1967, që e kam cekur më sipër në këtë artikull.

Tek e fundit, këtij artikulli i është mundësuar që citimit të 12 *Festivaleve Folklorike Ndërkombëtare* t’i shtohen edhe 6 të tjerë, për t’u përmbushur kështu numri zyrtar prej **18 festivalesh**. Nga ata, katër kanë qenë të anashkaluar (shih festivalet me numër 1, 3, 8, 11) dhe dy të shtuar (festivalet 17, 18 që nuk kanë kërkuar procese filmike).

Në mbyllje të këtyre zërave, **jam shpresëplotë** se dukuri të tilla dialektika e kohës do t’i tjetërsojë e pasurojë, sigurisht jo nga unë, por vetvetiu nga dikush tjetër.

Fundja

jo me hamendje,
por me reflekse faktologjike,
për sa u trajtua, ndonëse për herë të
parë, **Historiofestivalistika e
Folklorit Shqiptar**

do të përbënte event refleksesh dimensionale
në shndritjen e kulturës sonë kombëtare.

Në vend të epilogut

Meditim i autorit thurur me poetin popullor

Tubimi, manifestimi apo Festivali Folklorik, do të vezullonin si:

*Mirë se vini, mirë se vini,
të gjithë ngado që jini,
në këtë log, në këtë tapet,
lëndinë apo sido të jetë...
ku*

gërshetohen si rruaza shumëngjyrëshe.

*Kënga Majekrahi me Isopolifoninë,
Vallja Labërishte me Kcimin e Rugovës,
telat e çiftelisë me firomën e cyledyjares
Palëzimet e fustanellës me valëzimet e xhybletës,
por edhe
tradita e tharmit popullor
me
bashkëkohoren e etnisë shqiptare.*

Dhe më tej:

*Si mundet që gjithë këta njerëz
Të këndojnë e të kërcëjnë njëherësh!
Si ka mundësi që nuk shqetësohen
nga gjethet e tingujve komshi!*

*Kjo në muzikë quhet **kakofoni**,*

*Në të folurën e grave **potere**,*

*Në zhargonin e kafes **zallamahi**,*

*Në kodin e shpirtit **çmenduri**!*